



**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT**

Shkurt 2024

NJOFTIM

Në kuadër të projektit *Erasmus+* midis **Wrocław University of Environmental and Life Sciences** dhe **Universitetit Bujqësor të Tiranës**, shpallet thirrja për aplikime për shkëmbim studentësh për Semestrin e Dytë 2023-2024 (*Semestri i Verës*), në Wrocław, Poloni.

Në këtë projekt mund të aplikojnë studentët e *Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit (FBU)*. Thirrja është e hapur për **4 (katër) kuota** për të zhvilluar praktikën profesionale për një periudhë kohore 2 – 3 mujore.

Për t'u njohur më mirë me Universitetin, dhe Fakultetin pritës (*Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Shkencave të Ushqimit*), studentët mund të vizitojnë lidhjet më poshtë:

- Faqja web e Universitetit pritës: www.upwr.edu.pl/en/
- Faqja web e Fakultetit pritës: <https://wbinoz.upwr.edu.pl/en/>

Nga ana e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), si partner i projektit, bëhet një renditje paraprake e studentëve aplikues. Kjo renditje u dërgohet partnerëve. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është si më poshtë:

- Letër motivimi në anglisht
- Lista e notave
- CV në anglisht (Formati *Europass*)

Afati i fundit për aplikim është data **11 shkurt 2024**.

Dokumentacioni i kërkuar do duhet të dërgohet nëpërmjet email-it në adresën: erasmusoffice@ubt.edu.al dhe fhoxa@ubt.edu.al, e në CC ksulaj@ubt.edu.al.

Për më shumë informacion na vizitoni pranë zyrës së Projekteve dhe Kërkimit në UBT.